



|  |   |                     |  |
|--|---|---------------------|--|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo | <b>ZYRA E PERSONELIT<br/>         KANCELARIJA OSOBLJA</b> |                     | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok |
|  | 02 Nr.200 /18   | Data:<br>05.10.2018 |  |

Në bazë të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 12, paragrafi 4, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Komuna e Istogut nxjerr :

### K O N K U R S

#### Për Kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

**Drejtoria:** Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

**Titulli i vendit të punës :** Zyrtar/e për Zhvillimin e Aktiviteteve Muzikore në Qendrën Kulturore

**Lloji i pozitë:** Marrëveshje për Shërbime të Veçanta ( kohëzgjatja 6 muaj ).

**Numri i ekzekutuesve:** 1 ( një )

**Numri i Referencës:** 02Nr.200/18

**Orari i plotë:** 40 orë në javë

**Niveli i Pagesës :** 400

#### Detyrat dhe Përgjegjësit :

1. Të merret me aktivitetet kulturore;
2. Për nder të datave kombëtare dhe ndërkombëtare të organizoj aktivitete kulturore;
3. Të merret me organizimin e festivaleve për fëmijë dhe të rritur;
4. Për të gjitha aktivitetet duhet të jenë në koordinim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport;
5. Si dhe shërbime të tjera që rrjedhin nga natyra e aktiviteteve kulturore të paraqitura nga mbikëqyrësi.

#### Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë konkurrimi në këtë pozitë kane shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

#### Dokumentet:

- Dëshmi të kualifikimi shkollor: Akademia e Muzikës
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dy rekomandime;
- Dokument identifikimi;
- Certifikata e lindjes apo ekstrakti;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;

**Afati i Konkurimit:** Konkursi është i hapur pesëmbdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Data e shpalljes së konkursit: 05.10.2018 deri më datë 19.10.2018

**Paraqitja e kërkesave :** Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

*“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë “*

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen



**Menaxheri i Personelit**  
**Fatmir Bytyçi**